

Në bazë të nenit 91, paragrafit 3 të Ligjit të Mjedisit Jetësor („Gaz. Zyrtare e RM“ nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13 dhe 42/14) u përgatit

**PROÇESVERBALI PËR MBAJTJEN E DEBATIT PUBLIK PËR STUDIMIN E
VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NDAJ MJEDISIT JETËSOR DHE ASPEKTET SOCIALE
PËR NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS PËR GRUMBULLIMIN DHE TRAJTIMIN
E UJËRAVE TË ZEZA NË KOMUNËN E KËRÇOVËS**

Debati publik u mbajt në hapësirat e komunës së Kërçovës më 20.02.2015 me fillim në ora 12:00. Nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ishin të pranishëm z. Zoran Boshev, z-nj. Zllata Tërpevska, z-nj. Elena Mitrovska dhe z. Ismet Sadiku. Nga përgatitësi i Studimit për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor të pranishëm ishin z-nj. Menka Spirovska dhe z-nj. Ana Despodovska, si dhe hartuesi i Studimit të Fizibilitetit z. Xhorxh Tavullaris. Në debatin publik morën pjesë qytetarët e interesuar, organizatat joqeveritare, përfaqësues të komunës dhe medieve lokale.

Debatin e drejtoi Zoran Boshev me këtë rend dite:

1. Prezantimi i shkakut për mbajtjen e debatit publik
2. Prezantimi i -pjesëmarrësve;
3. Prezantimi i Studimit për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor
4. Diskutimi në lidhje me Studimin për VNMJ;
5. Mbyllja e debatit publik.

Pas përfundimit të dy pikave të para fjala iu dha z-nj. Menka Spirovska biolog i diplomuar- ekspert i autorizuar për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor, që ta prezantojë Studimin për VNMJ dhe aspektet sociale për ndërtimin e infrastrukturës për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Kërçovës.

Prezantimi filloi me përshkrimin e procedurës për vlerësimin e ndikimit të projektit ndaj mjedisit jetësor dhe përmbajtjen e Studimit për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor.


Gjatë prezantimit kujdes i posaçëm iu dha shqyrtimit të opsioneve alternative, ndikimeve të pritura ndaj mjedisit jetësor nga realizimi i projektit dhe masave të parapara për tejkalimin e të njëjtave.

Pas përfundimit të prezantimit u hap diskutim i hapur në të cilin fjalën e morën të pranishmit në këtë debat publik.

Z. Shasim Osmani bëri këto vërejtje:

Pyetja/konstatimi: Lokacioni i SPUZ është definuar me PUGJ unë e di se gjatë sjelljes së PUGJ më së paku vëmendje iu kushtua kësaj. U vendos që të kënaqë disa kërkesa dhe të vendoset në ndonjë kornizë. Me planifikimin e zgjerimit të qytetit të Kërçovës, mendoj se me këtë lokacion në pikëpamje të gravitetit nuk mund të përfshihen të gjitha ujërat fekale të kësaj komune. Mendoj se disa pjesë të komunës ndodhen në një lartësi më të ulët mbidetare nga lokacioni i paraparë për SPUZ.

Përgjigja:



Z. Bekim Mustafaj (komuna e Kërçovës) –Pjesa jugore e qytetit dhe vendbanimi Drugovë është paraparë që përmes një kolektori të lidhen me SPUZ. Ky lokacion është në pjesën më jugore të zonës urbane.

Z-nj. Menka Spirovska: Ndërtimi i kolektorit do të realizohet në fazën e dytë të projektit, përkatësisht përmes Projektit për përmirësimin të rrjetit të kanalizimit, që do të fillojë në vitin 2017 .

Pyetje/konstatim: Personalisht mendoj se numri i paraparë i 45.000 e.b. i SPUZ është shumë i vogël!?

Përgjigja:

Z. Xhorxh Tavullaris dhe z-nj. Menka Spiroska - Numri i banorëve bazohet në kufijtë e dhënë në direktivat e BE-së, gjithashtu numri prej 45.000 e.b. është dimensionuar që ti përfshijë ujërat e zeza të vendbanimeve më të mëdha në aglomeracionin e Kërçovës, e jo të gjitha të voglat sepse një pjesë gjenden në zona të pakapshme apo sjellja e kolektorit dhe ndërtimi janë të pazbatueshëm nga këndvështrimi ekonomik.. Kjo do të rezultojë me rritjen e kostos së shërbimit për banorët. Për këto vende të vogla ekziston mundësia e zbrazjes së gropave septike në SPUZ ose ndërtimi i sistemeve të vogla module për trajtimin e ujërave të zeza e që do të jenë më të zbatueshme (më me llogari). Gjithashtu me këtë kapacitet poqë se menaxhohet në mënyrë të drejtë me SPUZ në të njëjtën mund të trajtohen ujëra të zeza për 49.000 e.b. Vendbanimi Vraneshticë për shkak të lokacionit është e pa mundur të lidhet me SPUZ të paraparë. Për këtë vendbanim do të duhet të ndërtohet një sistem i posaçëm për trajtimin e ujërave të zeza ose zbrazja e gropave septike mund të trajtohet në SPUZ e paraparë..

Pyetje/konstatim: Unë i njoh mirë vendbanimet Zajaz dhe Osllomej. Në komunën e Zajazit një numër i madh i vendbanimeve dhe fshatrave kanë ndërtuar rrjetin e vet të kanalizimit, e që ndodhen me një largësi prej rreth 4-5 km nga kolektori i paraparë. Sipas meje nuk ka logjikë që këto vendbanime mos të lidhen me kolektorin kryesorë në komunën e Kërçovës dhe të ndërtojnë sisteme të posaçme për trajtimin e ujërave të zeza.

Përgjigja:

Z-nj. Menka Spirovska gjithë këto aspekte janë analizuar në mbledhjet teknike me këtë komunë dhe me NPK „Komunalec“. Siç e theksova më parë se faza e dytë e projektit parasheh që të gjitha komunat e mëparshme, e tani vendbanime të komunës së Kërçovës përmes kolektorëve kryesorë ose rrjetit primar të kolektorit të lidhen me kolektorin kryesorë deri te SPUZ dhe është vlerësuar se SPUZ i ardhshëm që do të jetë me një kapacitet prej 45.000 e.b., por me mundësi për ti trajtuar ujërat e zeza deri në 49.000 e.b. Në këtë mënyrë do të përmbushen nevojat edhe të Zajazit dhe Osllomesë, si dhe të vendbanimeve të tjera.

Pyetje/konstatim: mendoj se kapaciteti i SPUZ do të jetë i vogël për banorët e kësaj komune!?

Përgjigja:



Z-nj. Menka Spirovska- Siç u cek edhe më parë. SPUZ në fillim u projektua për 60.000 e.b., por kjo vlerësua në bazë të rritjes së rregullt të popullatës gjatë disa viteve të fundit. Puna e SPUZ do të ketë një kosto të lartë. Është shumë e rëndësishme që të fillohet gradualisht me punë SPUZ, e nëse ka nevojë reale, SPUZ mund të zgjerohet në pajtim me nevojat..

Z. Nazmija Sadiku-inspektor komunal

Pyetja: sa është gjatësia e kolektorit kryesorë?

Përgjigja:

Z-nj. Menka Spirovska -kolektori kryesorë do të jetë me një gjatësi prej 3,6 km. Kompletimi i rrjetit të infrastrukturës së plotë do të bëhet në fazën e dytë të zbatimit të projektit.

Z. Radovan Angelevski- EKIPI Inxhiniering

Pyetje/konstatim: Unë e përshëndes këtë projekt. Paralelisht duhet që të mendohet edhe për zgjidhjen e problemit me deponinë. Për shkak se kjo është pjesë nga ndotja në Kërçovë dhe më gjerë. Deponia është problemi më i madh i komunës së Kërçovës. A nuk është mirë që tani paralelisht të punohet për këtë problem?

Përgjigje:

Z. Zoran Boshev – Tani jemi në prezantimin e Studimit për SPUZ për ujërat e zeza. Deponia nuk është pjesë e debatit të sotëm. Problemet zgjidhen hap pas hapi. Tani është vendosur që për momentin të bëhet SPUZ, sepse ekziston mundësi që përmes IPA-s dhe Qeverisë së RM-së të financohet ky projekt.

Z-nj. Menka Spirovska - Në këtë studim janë shqyrtuar edhe projektet e ardhshme zhvillimore në komunën e Kërçovës, që lidhen me këtë projekt edhe atë janë: Projekti për ndërtimin e infrastrukturës komunale në qytetin e Kërçovës dhe parashihet zbatimi i Projektit për rehabilitimin e deponisë së komunës. Projektet do të zbatohen gradualisht në varshmëri të financave. Është parashikuar deponi rajonale. Por, në fazën fillestare është e dobishme që kullimi nga deponia do të grumbullohet dhe trajtohet në SPUZ e paraparë.

Z. Koce Naumovski - REK Oslomej

Pyetje: Më intereson vallë se a është bërë vlerësimi i ndikimit nga dezinfektimi i ardhshëm i ujit në SPUZ?

Përgjigje:

Z-nj. Menka Spirovska – ky Studim për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor bëhet në bazë të Studimit të fizibilitetit ku mungojnë të dhënat e sakta për sasinë e klorit të cilat do të përdoren, meqenëse ky ndikim është identifikuar në Studimin dhe prandaj është parashikuar që operatori i ardhshëm të përpunoj planë për menaxhimin me kimikatet, si dhe të bëjë monitorim të ujit pas trajtimit në SPUZ, ndërsa para lëshimit në lumin Zajashka- recipientë (pranues).

Pyetje: Vallë a janë parashikuar ndikimet në rast të avarisë?

Përgjigje:

Z-nj. Menka Spirovska – Në këtë Studim është bërë planë i posaçëm, që i përfshinë incidentet e mundshme nga aspektit i:

- Incidenteve që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve;
- Incidenteve që kanë të bëjnë me substancat toksike ose të rrezikshme kimike;
- Zjarreve;
- Rreziqeve të mundshme dhe dëmeve nga aspektet fqinjësore industriale;
- Aktiviteteve sizmike - tërmete;
- Rrëshqitjes së tokës dhe
- Përmbytjeve.

Z. Ivica Nikollovski – NPK “Komunalec”

Pyetje/konstatim: Gjatë përpunimit të projektit edhe personalisht u interesova, sepse jetoj në pjesët jugore të qytetit të Kërçovës - në afërsi të deponisë. Vallë SPUZ do të ketë emisione me aromë, sepse basenet aeratorë janë të hapura, ndërsa deponia është gjithashtu në afërsi.

Përgjigje:

Z-nj. Menka Spirovska – Në këtë studim është bërë modelimi i përhapjes së aromës nga SPUZ, mendojmë se SPUZ është jashtë banimit, përkatësisht distanca e vendbanimeve është më e madhe se 500 metra. Mendoj se aroma nuk do të ketë ndikim të madh. Gjithashtu, në Maqedoni nuk ka rregullativë ligjore për aromën, ndërsa aroma varet individualisht nga perceptimi. Si masë në këtë studim është parashikuar mbyllja e objekteve nga të cilat do të gjenerohet aromë, nëse është e nevojshme

Njësitë për para-trajtim: stacioni pompë i ujës-jellës, së bashku me njësitë për trajtim mekanik të fraksioneve të mëdha, njësinë për mënjanimin e rërës dhe vajrave dhe njësinë për pranimin e zbrazjes së gropave skeptike janë mbuluar dhe për to është parashikuar ndërtim i njërive për kontrollin e aromës (që përbëhet nga gypat për thithje, ventilatorët dhe filtrat).

Basenet aeratorë do të jenë të hapur dhe nga to nuk pritet emisione të mëdha të aromës, sepse në to do të sigurohen me aeratorë të oksigjenit. Nëse gjatë punës së fazës operative emisionet e aromës kanë ndikim ndaj banorëve dhe qytetit të Kërçovës të njëjtat duhet që të mbulohen.

Nga **z. Goran Sazdov**- u dorëzuan vërejtje në formë të shkruar për të cilat kërkonte që të njëjtat të përgjigjen dhe dorëzohen në formë të shkruar.

Pas lodhjes së rendit të ditës, debati publik mbaroi në ora 14:45.

Pjesë përbërëse e këtij procesverbali është Lista e pjesëmarrësve, e dhënë në shtojcë.

Shkup 24.02.2015

Procesverbalin e përpiloi:
Zoran Boshev

